

VENDIM
Nr. 292, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM, RRUGA ‘PJETRUSHI’, PRANË VARREZAVE TË QYTETIT, GRUDË E RE”, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim, rruga ‘Pjetrush’”, pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re”, Bashkia Shkodër.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 326 970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 326 970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Shkodër

8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM ASFALTIM RRUGA ‘PJETRUSHI’, PRANË VARREZAVE TË QYTETIT, GRUDË E RE”, BASHKIA SHKODËR

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
											ARË				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Dede		Shkambi	221/10	1965	178-A	ARE	5900	2	112	724	270	195,480	195,480	
2	Mhill	Gjon	Zefi	221/15	1965	178-A	ARE	4000	4	69	487	270	131,490	131,490	
Vlera totale													326,970		